

VENDIM
Nr.61, datë 28.1.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.90, DATË 21.3.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-
BALLDRE, PJESË E SEKSIONIT LEZHË-SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.90, datë 21.3.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 3453 m² tokë arë, për një objekt, me vlerë 6 896 515 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, dru frutorë me vlerë 250 500 (dyqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, kultura bujqësore me vlerë 41 436 (dyzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme prej 10 341 040 (dhjetë milionë e treqind e dyzet e një mijë e dyzet) lekësh.”.

b) Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale për këtë shtesë shpronësimi është në shumën 294 000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.”.

c) Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë shtesë prej 10 635 040 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

2. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 28.2.2005.

3. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët në kolonën “Shënime” është shkruar “Plotësim dokumentacioni”, të marrin shpërblimin për efekt të shpronësimit pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor, nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU LEZHË

Lista e pronarëve që shpronësohen (shtesë e projektit) për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor Lezhë-Balldre (seksioni i I-rë)

Lloji i pasurisë: Tokë arë, kulturë bujqësore, dru frutorë dhe objekt nr.8

Nr.	Pronar			Nr. Pas.	Tokë arë			Objekt			Kultura Bujq. 12 lekë/m ²	Dru frutorë në lekë	Totali në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë				
1	Kole	Mark	Guri	13/61,13/68					preventiv	6896515			6896515	Plotësim dokumentacioni
2	Gjok	Dedë	Nika	349/12	511	913	466543				6132	32000	504675	Plotësim dokumentacioni
3	Zef	Pashko	Nika	350/10	382	913	348766				4584	96000	449350	
4	Zef	Pashko	Nika	349/15	750	913	684750				9000	0	693750	
5	Luk	Pashko	Nika	350/11	662	913	604406				7944	70000	682350	
6	Ndok	Fran	Gjoni	349/12	388	913	354244				4656	38000	396900	
7	Mikel	Ndok	Gjoni	349/11	114	913	104082				1368	14500	119950	
8	Luk	Rrok	Dedgjoni	447/4	646	913	589798				7752	0	597550	
	Shuma				3453		3152589			6896515	41436	250500	10341040	

Shpenzime procedurale lekë 294 000
Vlera totale e shpronësimit lekë 10 635 040